



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT BERAT

Nr. 152/11 Prot.

Berat, më 08.02.2023

**Vendim**

Nr. 5, Datë 08.02.2023

“Për Dhënie Titulli “Nder i Qarkut Berat” Z.Ardian Cerga

Në mbështetje të nenit 77, pika II të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Civile në Republikën e Shqipërisë” Ligjit nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr.861, datë 10.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Komisionit Këshillimor të Vlerësimit të Figurave në Këshillin e Qarkut Berat, materialit të shqyrtuar nga Komisioni Këshillimor, miratuar me Vendim nr. 10, datë 15.07.2020, “Për miratimin e rregullores së funksionimit të komisionit këshillimor në Këshillin e Qarkut Berat” i ndryshuar,

**Vendosi:**

**Të vlerësohet me titullin “Nder i Qarkut Berat” Z.Ardian Cerga**

1. Me motivacion: “Për kontribut dhe merita të veçanta në zhvillimin artit dhe kinematografisë në Qarkun e Beratit.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni Këshillimor pranë Qarkut Berat dhe Sekretari i Këshillit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 78 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

**KRYETAR**

**Donald MOLISHTI**

Këshilltar gjithsej: 18

Morrën pjesë në votim: 10

Votuan Pro: 10



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

KËSHILLI I QARKUT BERAT  
KOMISIONI KËSHILLIMOR

Berat më, 01.02 2023

RELACION

**“PËR DHËNIE TITULLI “NDER I QARKUT BERAT” Z.Ardian Cerga**

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Qarkut Berat.

Komisioni Këshillimori Vlerësimit të Figurave të Shquara të Qarkut Berat I cili funksionon në qark ka shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar me qëllim vlerësimit me titullin:  
“Nder i Qarkut Berat” Z.Ardian Cerga.

Ky propozim gjen mbështetje nëshkronjën “b”, pika 2 e nenit 8 të Rregullores së Brendshme të funksionimit të Komisionit të Vlerësimit të Figurave të shquara.

Kërkesa/propozimi e sipërcituar vjen nëmbështetje të Ligjit nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 861, datë 10.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”.

Në referim të sa mësipër, pas shqyrtimit të dokumentacionit shoqëruar nga ana e Komisionit Këshillimor dhe sipas procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e datës 07.02.2023, po ju paraqesim propozimin për vlerësimin me Titullin “Nder i Qarkut Berat” znj. Ardian Cerga

**Z.Ardian Cerga :**

- 1957- Nëntor 16 – Lindi ne Tiranë.
- 1977 – Diplomohet ,aktor në Institutin e Larte te Arteve (sot Universiteti i Arteve).
- 1980 - Transferohet në Qendren e Kultures Berat
- 1989 – 1991 – Emerohet në Teatrin Kombetar
- 2017 – Rikthehet në Teatrin Kombetar nga ku vijon te jete edhe sot.

**1983 - Themelon Teatrin Profesionist të Beratit së bashku me Sheri Mitën.**

**Ka kryer rreth 30 role në Teatër dhe Kinematografi prej të cilave mund të permendim:**

---

Këshillii Qarkut Berat, Blvd. “Republika”, Web: [www.qarkuberat.gov.al](http://www.qarkuberat.gov.al), E-mail: [info@qarkuberat.gov.al](mailto:info@qarkuberat.gov.al)

- 1981 – Role të shumta në Estradën amatore të qytetit
- 1982 – Vënie në skene me materiale humoristike në cilesinë e Regjisorit dhe Aktorit
- 1983 – „Dy krisma në Paris“ – Avni Rustemi.
- 1984 – „Përpjekja“ – Leka Bungo (në rolin e Petriti-t)
- 1984 – „Tufan në Dovlet“ – Luan Qafzezi (në rolin e dhëndërit).
- 1986 – „Komitet „ – Hysni Millosi (në rolin e kapos)
- 1989 – Unë dhe Mefistofeli“ në Dramën e Bashkim Hoxhës (në rolin e Aldo-s)
- 1990 – “Rajmonda” – Dramë nga Artur Zheji
- 1991 – “Kush e solli Doruntinën”. Regjia : Fatos Haxhiraj
- 2017 – “Pushteti i grave” – Spiro Duni(Urani)
- 2018 – “Tag” – Andia Xhunga
- 2019 – “Xhelatet” - Qendrim Rijani (në rolin e gardianit)
- 2020 – „Galaksia „ – Rovena Lule

#### Film:

- 1977- „Yje mbi Drin “– Ismail Zhabiaku ( në rolin e Inxhinierit)
- 1978 – “ Me hapin e shokëve” - Esat Teliti
- 1978 – “Era e ngrohtë e thellësive” – Vladimir Prifti
- 1978 - “ Mesonjetorja“ – Muharem Fejzo (në rolin e Komi-t)
- 1979 - “ Në çdo stinë“ –Viktor Gjika (në rolin e Leka-ës)
- 1988 - „ Pranvera nuk erdhi vetëm“ – Piro Milkani
- 1989 – „Njerëz në rryme“ – Besnik Bisha & Grigor Stavri
- 2000 – „Nata pa henë“ - Artan Minarolli
- 2005 – „ Lorizonte degli eventi “Film italian“
- 2008 – „ Il passato e una terra straniera“
- 2017 – „ Ne filmin Ndërkombetar“
- 2018 - „ Tirana km 100 “ Viktor Gjoka“


#### Filma dhe projekte te shumta teatrore në proçes.

- Së shpejti në filmin "Nena ime kozmonaute“ – Regjia Andi Deliana
- autor i skenarit dhe regjisë në filmin " Trendafilat e kuq“

Duke Ju falenderuar!

#### KOMISIONI KËSHILLIMOR:

1. Anëtar: Syrja Ormënaj



2. Kryetar: Ymer Kordha



3. Anëtar: Besjana Liçaj



4. Sekretar: Shpëtim Nishani



**Propozim**

**Për dhënie titulli Nderi Qarkut  
Zotit Ardian Cerga**

Komisioni i Vlerësimit të Figurave  
KESHILLI I QARKUT  
NR. 127 PROT.  
DATE 27.01.2023

Të nderuar anëtar të Komisionit të Vlerësimit të Figurave!  
Të nderuar anëtar të Këshillit të Qarkut Berat

Në prezantimin që vijon ju sjellim një propozim dhënie titulli "Nderi i Qarkut" për një figurë intelektuale, aktorit, Z. Ardian Cerga.

Lindur në Tiranë në 16 /11/1957, mbaruar shkollën e mesme në vitin 1975-1976, filluar studimet në Institutin e lartë të arteve ( sot Akademia e Arteve ) dhe diplomohet për aktor në vitin 1977 , mbaruar në vitin 1980 .Po në këtë vit filloj punë në qendrën e kulturës Berat ( masa që u mor ndaj tij ) qendrimi në Berat vazhdoj deri në vitin 1987 , në vitin 1989 emerohem në Teatrin Kombëtar dhe vazhdoj deri në vitin 1991 , me pas largohet në emigracion për tu rikthyer në Teatrin Kombëtar në vitin 2017

Aktiviteti teatral ;në vitin 1981 role në estradën amatore të qytetit , në vitin 1982 , vënë në skenë materiale humoristike si regjisor dhe si aktor , në vitin 1983 në Dramën "Dy krisma në Paris" Avni Rustemi , në vitin 1984 , rolin Petritit në dramën "Përpyjekja" të Leka Bungos" Perpyjekja" , në komedin "Tufan Ne devlet "(autor Luan Qafzezi ) rolin e dhëndërit , në vitin 1986 kapon në dramën " Komitet" ( autor Hysni Milloshi ), në vitin 1989 në Teatrin Kombëtar në dramën e Bashkim Hoxhës në rolin e Aldos në 'Unë dhe Mefistofel' , në vitin 1990 në dramën e Artur Zhejit 'Rajmonda' , në 1991 " Kush e solli Doruntinen,në vitin 2017, "Pushteti i grav" , 2018 "Tag" , 2019 "Xhelatët" , 2020" Galaksia"

Në kinematografi , në vitin 1977 filmi "Yje mbi Drin" roli i inxhinierit 1978,filmin Mësonjëtorja në viti 1978 në rolin e Komitetit ,film i Televiziv " Me hapin e Shokëve " , 1978 filmi "Era e ngrohtë e thëllesive" , viti 1979 filmi " Në çdo stinë" nga viti 1980 deri në vitin ,1988 ju hoq e drejta e interpretimit , në film 1988 filmi "Pranvera nuk erdhi vetëm" , në vitin 1989 filmin "Njerëz në rrymë" , në vitin 2000 filmi "Nata pa hënë" , në vitin 2005 filmin Italian "Lorizonte degli eventi" , në vitin 2008 në filmin Italian "il passato e una terra straniera",në vitin 2018 në filmin "Tirana km 100" në vitin 2017 në filmin "Ndërkombëtarët".

Filma dhe projekte te shumta teatrore në proces.

Së shpejti në filmin 'Nena ime kozmonaute' – Regjia Andi Deliana si dhe autor i skenarit dhe regjisë në filmin ` Trendafilat e kuq`

Jemi të bindur se është një figurë që e meriton plotësisht këtë titull.

**Qendra Rinore "The Youth of Ura" NIPT/Ss L73413133M  
Lagjja:18 Tetori ,Rruga Dimal,Ndërtesa Nr 15/1  
Dimal**

